

NJOHËSIT E PROCESEVE POLITIKE: KURTI NUK KA GATISHMËRI QË TË KETË KONSENSUS PËR PRESIDENTIN



Shumë organizata të shoqërisë civile u janë drejtuar me një letër publike partive politike parlamentare, nga të cilat kërkohet që të gjenet një zgjidhje për zgjedhjen e presidentit dhe të shmangen zgjedhjet e serishme. Njohësit e proceseve politike vlerësojnë se konsensusi për zgjedhjen e presidentit është domosdoshmëri

për stabilitetin institucional, por ata theksojnë se nuk ka gatishmëri të qartë nga Kurti që të ketë një konsensus për një president që nuk do të kontrollohet nga vetë ai. Analistët vlerësojnë se Kurti po shkon kah imponimi ose i Vjosa Osmanit, ose zgjedhjeve të reja të jashtëzakonshme

DERISA PRITEN FATURAT E REJA TË RRYMËS, KOSOVA PAGUAN EDHE PËR BLOKADËN SERBE



DEKLAROHEN TË PAFAJSHËM THAÇI, SMAKAJ, FAZLIU, KILAJ DHE KUÇI

AKTUALE



PAKISTANI SINJALIZON PËR “LUFTË TË HAPUR” KUNDËR QEVERISË TALIBANE NË AFGANISTAN

BEGAJ: SHOQIPTARËT NË MAQEDONINË E VERIUT JANË POPULL SHTETFORMUES

OSMANI I THOTË PRATTIPATIT SE PRANIA USHTARAKE AMERIKANE NË KOSOVË MBETET E RËNDËSISHME


EKONOMI



80 PËR QIND E MINATORËVE TË EKSPOZUAR NDAJ RREZIQEVE SERIOZE NË PUNË

RRITET KOSTOJA E NDËRTIMIT

SPORT



PËRFUNDON RRUGËTIMI HISTORIK I DITËS NË GARAT EVROPIANE

RENOVA

PUTZ

Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com



Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË



Kolegji
BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net



INFINITY

Digital Agency

Endrit Shaqiri

+38344685122

Internet Website,
Marketing...

PAKISTANI SINJALIZON PËR “LUFTË TË HAPUR” KUNDËR QEVERISË TALIBANE NË AFGANISTAN

KABUL, 27 SHKURT - Disa shpërthime kanë goditur Kabuln disa orë pasi Afganistani dhe Pakistani këmbyen sulme në rajonin kufitar. Dhuna shpërtheu pas disa ditësh tensione të larta dhe një zyrtar i lartë në Islamabad tha se kjo është “luftë e hapur”. “Kupa e durimit është mbushur. Tani është luftë e hapur mes nesh dhe jush [Afganistanit]”, tha ministri pakistanez i Mbrojtjes, Khawaja Muhammad Asif të premten.

Burimet lokale i thanë Radios Mashaal të Radios Evropa e Lirë se katër lokacione ishin nën sulm në kryeqytetin afgan, Kabul, në orët e para të 27 shkurtit, si dhe një bazë ushtarake në rajonin e Kandaharit.

Aeroplanë ushtarakë janë dëgjuar duke fluturuar teksa janë dëgjuar shpërthime në Kabul.

Zabihullah Mujahid, zëdhënës i qeverisë së udhëhequr nga talibanët në Afganistan, konfirmoi sulme në “disa zona të Kabulit, Kandaharit dhe Paktias”. Ai shtoi se nuk ka raportime për viktima.

Ushtria pakistaneze konfirmoi se aeroplanët e saj ushtarakë kanë bombarduar Kabuln. Mosharraf Zaidi, zëdhënës i qeverisë pakistaneze, tha përmes rrjeteve sociale se “kundërsulmet ndaj caqeve në Afganistan po vazhdojnë”. Sulmet në Kabul vijnë pas një përshkallëzimi të madh të armiqësive mes qeverisë afgane të udhëhequr nga talibanët dhe Islamabadit.

Vetëm disa orë më herët Mujahidi tha se Kabuli kishte nisur “një operacion sulmues në shkallë të gjerë kundër qendrave ushtarake dhe instalimeve ushtarake pakistaneze përgjatë Vijës Durand”, një kufi i paqëndrueshëm që përshkon territoret tradicionale fisnore të pashtunëve dhe baluçëve.

Ministria e Mbrojtjes e talibanëve pretendoi se 55 pjesëtarë të forcave të sigurisë së Pakistanit ishin vrarë, ndërsa dy baza dhe 19 poste ishin marrë nën kontroll përtej kufirit nga forcat e saj.

Trupat e Islamabadit u kundërpërgjigjën, thanë zyrtarët pakistanezë, ndërsa Zaidi deklaroi se gjithsej 133



pjesëtarë talibanë afganë janë “konfirmuar të vrarë” dhe mbi 200 të tjerë janë plagosur. “Vlerësohet se ka edhe shumë viktima të tjera nga sulmet ndaj objektivave ushtarake në Kabul, Paktia dhe Kandahar”, shtoi ai.

Këto pretendime të të dyja palëve nuk mund të verifikohen në mënyrë të pavarur, megjithatë një banor lokal i Kabulit i tha Radios Mashaal të REL-it se një “shpërthim i madh” tronditi qytetin.

Kryeministri i Pakistanit, Shehbaz Sharif, tha se forcat e shtetit të tij janë të gatshme të “mbrojnë sigurinë, sovranitetin

dhe integritetin territorial të vendit”. “Ushtria pakistaneze është e vendosur të mos lejojë që paqja dhe siguria e vendit të komprometohen në asnjë rrethanë”, shkroi ai në X.

Vala më e fundit e sulmeve erdhi pasi sulmet ajrore pakistaneze, katër ditë më parë, vranë të paktën 18 persona në provincat Nangarhar dhe Paktika të Afganistanit.

Pakistani tha se i kreu ato sulme ndaj shtatë caqeve militante brenda Afganistanit si një “përgjigje hakmarrëse” ndaj sulmeve të fundit vetëvrasëse, të cilat tha se ishin kryer nga ekstremistë me bazë në Afganistan.

Pakistani pretendoi se nga këto sulme u vranë 80 militantë.

Strukturat e sigurisë afgane të drejtuara nga talibanët e mohuan këtë pretendim, duke e cilësuar si “të rremë”, teksa zyrtarë qeveritarë thanë gjithashtu se po përgatisnin “një përgjigje të përshtatshme dhe të kalkuluar”.

Afganistani i mohon akuzat e Pakistanit se po strehon talibanët pakistanezë, që janë një degë e talibanëve afganë që duket se operojnë në mënyrë të ndarë.

Tensionet kanë qenë të larta mes dy shteteve që kur Pakistani kreu sulme ajrore ndaj Kabulit në tetor të vitit 2025, dhe më pas kreu sulme shtesë në territorin afgan.

Dhjetëra ushtarë nga të dyja palët u vranë në përleshje me artileri dhe shikëmbime të rënda zjarri vitin e kaluar, para se të arrihej një armëpushim, që u ndërmjetësua nga Katari.

Megjithatë, disa raunde bisedimesh të ndërmjetësuar nga Katari dhe Turqia, që kishin për synim uljen e tensioneve përgjatë kufirit, kanë dështuar të sjellin një përparim afatgjatë.

INTELIGJENCA AMERIKANE HEDH POSHTË PRETENDIMET E TRUMPIT PËR RAKETAT IRANIANE



UASHINGTON, 27 SHKURT - Presidenti amerikan Donald Trump ka thënë se Irani së shpejti do të ketë raketa që mund të godasin Shtetet e Bashkuara. Megjithatë zyrtarë të inteligjencës amerikane thonë se ky pretendim nuk mbështetet nga informacionet aktuale të inteligjencës amerikane dhe duket i ekzagjeruar, sipas tre burimeve të njohura me raportet e inteligjencës.

Në fjalimin e tij “State of the Union” përpara Kongresit amerikan, Trump filloi ta paraqesë këtë pretendim si një

pjesë të arsytimit për një sulm të mundshëm kundër Iranit, duke thënë se Teherani është “duke punuar për raketa që së shpejti do të arrijnë” Shtetet e Bashkuara, shkruan “Reuters”.

Megjithatë, sipas burimeve, nuk ka pasur ndryshime në një vlerësim publik të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes të ShBA-së (DIA) të vitit 2025, i cili thotë se Irani mund të ketë nevojë të paktën deri në vitin 2035 për të zhvilluar një raketë ndërkontinentale balistike (ICBM) të aftë ushtarakisht, duke përdorur teknologjinë

ekzistuese të lëshimit të satelitëve.

Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, e përshkroi programin e raketave të Iranit si “në rrugë për të zhvilluar një ditë armë që mund të arrijë ShBA-në”, por zyrtarët e inteligjencës nuk kanë gjetur prova të një kërcënimi të menjëhershëm.

Irani vetë mohoi se po punonte për raketa të tilla me rreze të gjatë dhe thotë se programet e tij janë për vetëmbrojtje dhe se raketat aktuale nuk janë të projektuara për të kërcënuar territore amerikane.

Amerikanët “bëhen anglezë”, rekord aplikimesh për shtetësinë britanike

LONDËR, 27 SHKURT - Numri i shtetasve amerikanë që aplikuan për shtetësi britanike mbërriti një nivel rekord gjatë vitit të parë të mandatit të dytë të presidentit Donald Trump në Shtëpinë e Bardhë, sipas Bloomberg.

Media e njohur citon të dhënat e Ministrisë së Brendshme britanike, të publikuara së

fundi sipas të cilave 8,790 amerikanë aplikuan për shtetësi përmes regjistrimit ose natyralizimit në vitin 2025. Kjo përfaqëson një rritje prej plot 42 për qind krahasuar me vitin 2024, kur u regjistruan gati 6.200 aplikime.

Niveli i aplikimeve duket se është rritur ndjeshëm sidomos në tremujorin e fundit të vitit të

kaluar. “Po vazhdon të ketë një shtim të interesit nga ShBA-ja s ai takon lëvizshmërisë globale, dhe shtetësia përbën një element kyç të këtij fenomeni”, deklaroi Nick Rollason, drejtues i departamentit të emigracionit në firmën ligjore Kingsley Napley.

Shifra të tilla po interpretohen si dëshmi e faktit që gjithmonë

e më shumë amerikanë po i kërkojnë mundësitë e tyre jashtë vendit, në një kohë kur Trump ka intensifikuar përpjekjet për të riformësuar ekonominë dhe institucionet bazuar në politikën e tij “Amerika e Para”.

Vitin që shkoi universitetet britanike regjistruan një rritje të interesit nga studentët



amerikanë, raporton Bloomberg, ndërsa edhe shpalljet për vende pune në Mbretërinë e Bashkuar po i joshin gjithmonë e më shumë qytetarët amerikanë.

Begaj: Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut janë popull shtetformues

PRISHTINË, 27 SHKURT - Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, në fjalimin e tij në një konferencë të përbashkët për medie me presidenten e Maqedonisë së Veriut, Gordana Siljanoska Davkova, tha se të dy vendet janë një shembull i bashkëpunimit rajonal dhe tha se të dyja palët janë të vendosura ta thellojnë këtë bashkëpunim. “Gjatë

bisedës sonë, vlerësuam marrëdhëniet shumë të mira, miqësore dhe intensive, që kemi si vende fqinje dhe angazhimin e përbashkët për të çuar përpara bashkëpunimin dypalësh, bashkëpunimin rajonal dhe më gjerë brenda organizatave ndërkombëtare. Gjatë bisedës, theksuam se marrëdhëniet midis vendeve tona janë një

shembull i bashkëpunimit rajonal dhe se të dy vendet tona mbeten të vendosura për të thelluar më tej këto nivele bashkëpunimi”, tha Begaj. Begaj tha se shqiptarët që jetojnë në RMV janë një faktor i rëndësishëm dhe shtetformues. “Një vend i rëndësishëm i është kushtuar faktorit shqiptar dhe shqiptarëve që jetojnë në

Maqedoni. Ata janë një popull shtetformues në këtë vend, duke kontribuar në mënyrë aktive në stabilitetin politik në qeverisje dhe orientimet euroatlantike. Zbatimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit nuk është një çështje teknike, por themelore që ka të bëjë me kohezionin social, bashkëpunimin ndëretnik dhe bashkëpunimin institucional”,



tha presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj.

RAMA BËN NDRYSHIME NË KABINETIN QEVERISËS


TIRANË, 27 SHKURT - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka bërë disa ndryshime të mëdha në kabinetin qeverisës, duke shkarkuar shtatë ministra, përfshirë zëvendëskryeministren dhe ministres e Energjisë, Belinda Balluku, e cila është nën hetime për korrupsion, raportoi televizioni shtetëror shqiptar, RTSh. Sipas RTSh-së, në mesin e të shkarkuarve gjatë një mbledhjeje të enjten pasdite është edhe ministrja e Jashtme, Elisa Spiropali.

As Rama e as qeveria e tij nuk kanë folur ende për arsyet e këtyre ndryshimeve, të cilat ndodhën pas protestave antiqeveritare muajt e fundit nga partia e ish-kryeministrit Sali Berisha dhe akuzave për korrupsion ndaj ministrave të Ramës.

Këto ndryshime vijnë pesë muaj pasi u betua qeveria e re e Ramës në shtator.

Autoritetet shqiptare filluan hetimet në fund të vitit të kaluar mbi dyshimet për korrupsion kundër Ballukut dhe zyrtarëve të tjerë.

Prokuroria e Posaçme kundër



Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) ngriti aktakuzë kundër Ballukut tetorin e kaluar dhe i ka kërkuar Kuvendit t’ia heqë imunitetin në mënyrë që të jetë në gjendje ta arrestojë atë.

Balluku akuzohet se ka bërë shkelje gjatë dhënies së tenderëve, po ajo i ka mohuar akuzat si “hedhje balte, insinuata, gjysmë të vërteta dhe gënjeshtër”.

Hetimet për korrupsion nxitën protesta kundër qeverisë së Ramës të cilat në raste janë përshkallëzuar në përleshje në mes të protestuesve dhe oficerëve të Policisë në Tiranë. Pas vendimit të Ramës të enjten, lideri i Partisë Demokratike në opozitë, Sali Berisha, postoi një video në “Facebook”, duke thënë se Rama “po kërkon ta shpëtojë lëkurën e vet”. “Kjo është një

lëvizje që fton qytetarët shqiptarë dhe opozitën t’i vazhdojë protestat, sepse kryengritja paqësore shqiptare kërkon shpëtimin e Shqipërisë nga Edi Rama dhe jo kukullat e tij. Me lëvizjen e tij, ai përpiket t’i mashtrojë njerëzit, në një kohë kur ai vetë është kreu i organizatës kriminale që drejton”.

Ai i bëri thirrje Ramës përsëri të japë dorëheqje, përndryshe “do

të përballët me popullin shqiptar”.

Ndryshimet e Ramës

Kryeministri Rama e shpalli riorganizimin e thellë të kabinetit qeveritar gjatë një mbledhjeje të përbashkët të mbajtur mes grupit parlamentar të Partisë Socialiste dhe anëtarëve të qeverisë. Balluku u zëvendësua nga Albana Koçi në postin e zëvendëskryeministres. Besfort Lamallari tani do ta drejtojë Ministrinë e Brendshme, duke e zëvendësuar Koçin, dhe duke ia lënë Ministrinë e Drejtësisë Toni Gogut.

Diplomati Ferit Hoxha do ta zëvendësojë Spiropalin si ministër për Evropë dhe Punë të Jashtme.

Balluku u zëvendësua nga Enea Karakafi në krye të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ermal Nufi u emërua ministër i Mbrojtjes duke zëvendësuar Pirro Vengun.

Dhe Eriona Ismaili u vu në krye të Ministrisë për Marrëdhëniet me Parlamentin në vend të Toni Gogut.

RRITET KOSTOJA E NDËRTIMIT



PRISHTINË, 27 SHKURT - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Kostos së Ndërtimit (IKN) për tremujorin e katërt (TM4) 2025.

Indeksi i tërësishëm i Kostos së Ndërtimit në Kosovë (IKN) pati rritje për 0,5 % në TM4 2025 krahasuar me TM3 2025. Ndërkaq, krahasuar TM4 2025 me të njëjtën periudhë të vitit paraprak (TM4 2024), Indeksi i

Kostos së Ndërtimit pati rritje për 3,5 %.

Indeksi i tërësishëm i Kostos së Ndërtimit në Kosovë (IKN) pati rritje për 0,5 % në tremujorin e katërt (TM4) 2025 krahasuar me tremujorin e tretë (TM3) 2025. Rritje kishte te: transporti (3,5 %); pagat (1,2 %); kostot e tjera (1,2 %); materialet (0,3 %) dhe energjia (0,2 %). Ndërsa rënie kishte te makineritë (-0,1

%).

Indeksi i tërësishëm i Kostos së Ndërtimit në Kosovë (IKN) pati rritje për 3,6 % në tremujorin e katërt (TM4) 2025 krahasuar me tremujorin e katërt (TM4) 2024. Rritje më të madhe kishte energjia (9,8 %); pagat (8,1 %); kostot e tjera (5,3 %); transporti (4,4 %); dhe materialet (2,6 %). Rënie kishte te makineritë (-0,4 %).

Haradinaj: Kurti po e çon Kosovën drejt zgjedhjeve

PRISHTINË, 27 SHKURT - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka kritikuar kryeministrin Albin Kurti, duke thënë se procesi i zgjedhjes së presidentit po përdoret si mjet për ta çuar vendin drejt zgjedhjeve të reja. Sipas Haradinajt, Kurti po

synon krijimin e një situatë që mund të përfundojë me zgjedhje të reja parlamentare. “Krejt çka i ka marrë prej Vjosës, fare s’po investon për Vjosën. Dhe nëse e qet ka me qit veç me na dërguar në zgjedhje. Kurti është ka do për

të na dërguar në zgjedhje, dhe në zgjedhje po na çon. Dhe i kisha thënë presidentes fare mos i mbledh nënshkrimet, se është veç sa për të qitur në peshore. Kurti është duke ia luajtur lojën asaj, sepse po i dhimbet çfarëdo qoftë që e ka

mbërri. E suksesi 51 për qind është me ndihëm e Vjosës, po i dhimbset për t’ia kthyer edhe qoftë 1 për qind. S’po ka mëshirë politike ndaj askujt, sepse po do një kontroll të plotë, ai dhe vetëm ai”, ka thënë Haradinaj.





NJOHËSIT E PROCESEVE POLITIKE: KURTI NUK KA GATISHMËRI QË TË KETË KONSENSUS PËR PRESIDENTIN

Shumë organizata të shoqërisë civile u janë drejtuar me një letër publike partive politike parlamentare, nga të cilat kërkohet që të gjendet një zgjidhje për zgjedhjen e presidentit dhe të shmangen zgjedhjet e serishme. Njohësit e proceseve politike vlerësojnë se konsensusi për zgjedhjen e presidentit është domosdoshmëri për stabilitetin institucional, por ata theksojnë se nuk ka gatishmëri të qartë nga Kurti që të ketë një konsensus për një president që nuk do të kontrollohet nga vet ai. Analistët vlerësojnë se Kurti po shkon kah imponimi ose i Vjosa Osmanit, ose zgjedhjeve të reja të jashtëzakonshme

PRISHTINË, 27 SHKURT - Pak ditë e ndajnë Kosovën nga zgjedhja e presidentit/es, ose vendi do të shkojë në zgjedhje parlamentare të jashtëzakonshme. Asnjë emër konsensual deri tash nuk e kanë gjetur partitë politike parlamentare. Konsensus nuk ka as për presidenten aktuale Vjosa Osmani, e cila ka shprehur vetë kandidaturën. Kjo e fundit tashmë është deklaruar se dëshiron të kandidojë edhe për një mandat pesëvjeçar, por për kandidimin e saj nevojiten të paktën 30

nënshkrime të deputetëve, të cilat Osmani akoma nuk i ka siguruar. Presidentja Osmani nuk ka folur publikisht nëse ka siguruar nënshkrimet e nevojshme për kandidimin e saj. Por zyrtarisht akoma nuk ka zgjidhje. Pas një takimi që zhvilloi me të ngarkuarën e ambasadës amerikane në Prishtinë, Anu Prattipati, Osmani përmendi rëndësinë e përmbylljes së proceseve kushtetuese dhe konsolidimit të plotë institucional, në funksion të, siç thotë ajo, “stabilitetit demokratik,

zhvillimit të vendit dhe adresimit të nevojave të qytetarëve”.

LV-ja akoma nuk ka mbledhur nënshkrime

Shumica në Kuvendin e Kosovës, që përbëhet nga Lëvizja Vetëvendosje dhe pakicat joserbe, nuk dëshiron të propozojë një emër të tyre për president apo presidente, për faktin se i kanë vetëm 66 vota në Kuvend. E pa votën e partive opozitare nuk arrihet numri prej 80 votash të

nevojshme për zgjedhjen e presidentit, prandaj kërkohet konsensus. Këtë qëndrim e shprehu zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Glauk Konjufca. “Ajo mazhorancë që është prej 66 numrash në Kuvend, ne jemi bindur që nuk ka mundësi, përmes një emri që propozohet, një emër i njëanshëm, ta marrim edhe votën e garantuar të opozitës për t’i bërë 80 vota. Ky është konstatimi i mazhorancës. Nuk po them se është absolut, sepse gjëra absolute në politikë nuk ka, por me përafërsi ky është konkludimi i mazhorancës”, thotë Konjufca, duke shtuar se shumica do që ta shmangë idenë që të propozojë një kandidat të vetin.

Qëndrimet e opozitës

Dy udhëheqësit e dy partive politike opozitare, PDK dhe LDK, që zhvilluan takime me kryeministrin Kurti, kërkojnë që emri i kandidatit për këtë post të ketë mbështetje të

gjerë. Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, thotë se “zgjedhja e presidentit nuk është çështje vetëm e një partie, por e të gjithë përfaqësuesve të zgjedhur”. “Si subjekt politik opozitar, nuk kemi qenë dhe nuk jemi pengesë e proceseve shtetërore, por as nuk mbështesim kandidatura që nuk përfaqësojnë unitetin qytetar, sipas frymës kushtetuese. Uroj që të ketë reflektim nga ata që e kanë përgjegjësinë kushtetuese për të propozuar kandidatura me mbështetje të gjerë, duke shmangur kalkulimet afatshkurtra partiake. Stabiliteti institucional është jetik dhe duhet të trajtohet si i tillë”, thotë Hamza.

Nga ana tjetër, kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, thotë se procesi i zgjedhjes së Presidentit po zhvillohet brenda një afati të kufizuar kohor dhe në këtë linjë ai kërkon “përgjegjësi të lartë politike, qartësi, maturi dhe

DEKLAROHEN TË PAFAJSHËM THAÇI, SMAKAJ, FAZLIU, KILAJ DHE KUÇI

HAGË, 27 SHKURT - Në Gjykatën Speciale të premtën në Hagë kanë filluar deklaratat hyrëse në gjykimin ndaj Hashim Thaçi, Bashkim Smakaj, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçi. Të pesë të akuzuarit në rastin për pengim të drejtësisë janë deklaruar të pafajshëm. Aktakuza pretendon se për disa muaj gjatë vitit 2023 ata kanë ndikuar në çështjen gjyqësore ndaj Thaçi, dhe tre ish-eporëve të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të

Kosovës për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Sipas Prokurorisë, Bashkim Smakaj mban përgjegjësi penale-individuele për pikën 12: tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare me anë të pjesëmarrjes në veprime të përbashkëta të një grupi midis së paku 9 shtatorit dhe 30 tetorit 2023, raporton “Betimi për Drejtësi”. Në pikën 13, Bashkim Smakaj, sipas Prokurorisë,

akuzohet për mosbindje ndaj gjykatës së paku në mes 9 shtatorit dhe 30 tetorit 2023. Isni Kilaj përmendet në pikën e 14 të aktakuzës dhe sipas Prokurorisë mban përgjegjësi penale për tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare me anë të pjesëmarrjes në veprime të përbashkëta të një grupi midis 6 tetorit dhe 2 nëntorit 2023. Ngjashëm sikur Smakaj, në pikën 15, Kilaj akuzohet për mosbindje ndaj gjykatës

midis së paku 6 tetorit dhe 2 nëntorit 2023. Kurse në pikën 16 Fadil Fazliu, sipas Prokurorisë, mban përgjegjësi penale-individuele për tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare me anë të pjesëmarrjes në veprime të përbashkëta të një grupi midis së paku 26 qershorit dhe 18 korrikut 2023. Në pikën 17 Fazliu ngarkohet me veprën penale për mosbindje ndaj gjykatës

midis së paku 26 qershorit dhe 18 korrikut 2023. Ndërsa Hajredin Kuçi mban përgjegjësi penale individuale për pikën 18 të aktakuzës e që, sipas Prokurorisë, është “mosbindje ndaj gjykatës” që dyshohet se është kryer 1 dhe 13 shtatorit 2023. Ndërsa pika e radhës është sërish mosbindje ndaj gjykatës për Kuçin që dyshohet se është kryer midis së paku 26 qershorit dhe 18 korrikut 2023.



vullnet për kompromis”. “Është thelbësore të kuptohet se Presidenca duhet të mbetet institucion që garanton ndarjen e pushteteve dhe shërben si faktor uniteti për vendin, e jo si vazhdim i shumicës qeverisëse. Në këtë frymë, dhe në përputhje me deklaratën politike të miratuar në Kuvendin e LDK-së, vlerësoj se ekzistojnë dy rrugë të qëndrueshme përpara: ose një konsensus i gjerë parlamentar rreth një emri të përbashkët për President, ose një marrëveshje politike ndërmjet partive parlamentare”, thotë Abdixhiku. Sipas tij, nëse asnjëra zgjidhje nuk merr rrugë, “vendit i vijnë zgjedhjet, një skenar i panevojshëm në këtë kohë”.

Qëndrimet e shoqërisë civile

Analistët thonë se do të ishte pjekuri politike që të ketë një konsensus politik për çështjen e Presidentit, por, si duket, nuk ka gatishmëri. “Nuk ka gatishmëri të qartë nga Kurti që të ketë një konsensus për një president që nuk do të kontrollohet nga Kurti. Do të ishte shumë pozitive që Kurti të bëjë një propozim për president jashtë VV-së dhe Listës Guxo. Megjithatë, mendoj se Kurti po shkon kah imponimi ose i Vjosa Osmanit, ose zgjedhjeve të reja të jashtëzakonshme. Se a do të arrijë të imponojë me detyrim, pritë të shihet”, thotë për DW analisti Blerim Burjani. Sipas tij, nëse Kurti nuk e arrin këtë, do të ishte zhgënjim i madh

për të, për faktin që ai paraqet fuqinë politike më të madhe në Kosovë dhe ka përgjegjësinë që të shmangë jostabilitetin institucional. “Edhe bashkësia ndërkombëtare do të befasohej për keq që Kosova të mos e tejkalojë këtë gjendje sa i përket zgjedhjes së Presidentit. Kjo po i bie jo pjekuri demokratike, kthim në stadin fillestar të shtetësisë, ku ka pasur nevojë për ndërhyrje ndërkombëtare për të shmangur problemet dhe konfliktet politike në vend”, thotë Burjani, duke vlerësuar se “duhet të demonstrohet pjekuri, vigjilencë dhe arsye për të mbështetur shtetësinë, demokracinë dhe bashkëpunimin ndërkombëtar”. Duke e parë “rrezikun” real që Kosova të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme sërish, shumë

organizata të shoqërisë civile u janë drejtuar një letër publike partive politike parlamentare, nga të cilat kërkohet që të gjendet një zgjidhje për zgjedhjen e presidentit dhe të shmangen zgjedhjet e serishme. “Konsensusi për zgjedhjen e presidentit është domosdoshmëri për stabilitetin institucional. Zgjedhjet e përsëritshme të parakohshme nuk duhet të konsiderohen si instrument për të garantuar funksionimin e institucioneve. Përkundrazi, ato e rrisin pasigurinë dhe dëmtojnë vazhdimësinë institucionale. Një president i zgjedhur me konsensus ofron stabilitet, siguron funksionimin normal të pushteteve dhe rrit besimin qytetar në institucionet e shtetit”, thuhet mes tjerash në letrën e publikuar nga shoqëria civile.

Sidoqoftë, Parlamenti i Kosovës duhet të zgjedhë presidenten apo presidentin e vendit më së largu deri më 04.03, pra jo më vonë se 30 ditë para përfundimit të mandatit të presidentes aktuale, Vjosa Osman. Mandati i saj përfundon më 4 prill 2026. Për të garuar për president të vendit, një kandidati i duhet t’i sigurojë të paktën 30 nënshkrime të deputetëve, ndërsa nevojiten dy të tretat e votave në Kuvendin e Kosovës me 120 deputetë. Kuorumi në Kuvend arrihet me 80 deputetë. Nëse në dy rundet e para të votimit një kandidat nuk i siguron 80 vota, atëherë në votimin e tretë mjafton t’i ketë 61 sosh. Dështimi eventual do të çonte Kosovën në zgjedhje të parakohshme parlamentare.

MATEMATIKË POLITIKE ME PAGAT E FUNKSIONARËVE NË MAQEDONINË E VERIUT



SHKUP, 27 SHKURT - A do të ulen apo do të rriten pagat e funksionarëve është pyetja që u shtrua në publik pasi në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut, me procedurë të përsheptuar, kaloi paketa e ligjeve me të cilat u ul koeficienti me të cilin llogaritet paga e tyre. Bëhet fjalë për ndryshime në ligjet për pagat e deputetëve, pagat e personave të zgjedhur dhe të emëruar, gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe anëtarëve të Këshillit të Prokurorëve dhe Këshillit Gjyqësor.

Këto ndryshime vijnë vetëm pak ditë para se në llogaritë bankare të mbi një mijë funksionarëve të emëruar paga e muajit shkurt të dalë më e “ulët”.

Pyetja që u ngrit në publik është për sa denarë do të jetë më e ulët paga që funksionarët do ta marrin në mars. Praktikisht, ulja e koeficientit që propozojnë deputetët “e ha” rritjen e bazës, prandaj ndikimi neto është minimal, sipas sindikatave. Kjo do të thotë se me ndryshimet e propozuara ulet koeficienti që shumëzohet me pagën mesatare për kryeministrin, presidentin e shtetit, kryetarin e Kuvendit, ministrat, deputetët, kryetarët e komunave dhe drejtorët.

Kryeministri Hristijan Mickoski, i cili sipas të dhënave të fundit në faqen e internetit të qeverisë kishte pagë bazë prej 140.450 denarësh (rreth 2.278 euro), me uljen e koeficientit nga 3.47 në 3.17, në mars do të marrë pagë prej 140.469 denarësh (rreth 2.279 euro). Nëse kësaj llogaritjeje i shtohet edhe stazhi i kryeministrit prej 12-përqindësh, paga e tij bazë, pa shtesat e tjera në pagë, do të arrijë në 157.569 denarë. Nëse koeficienti nuk do të ulej, me harmonizimin me pagën mesatare për vitin 2024 që

merret si referencë, ai do të duhej të merrte 153.762 denarë bazë, që me stazhin do të arrinte në 184.514 denarë.

Paga bazë e presidentes Gordana Silanovska Davkova është 140.469 denarë, ndërsa meqë ajo tashmë ka plot 40 vite stazh, kjo do të thotë se baza do të arrijë në 168.824 denarë.

Koeficienti i deputetëve me ndryshimet e propozuara pritet të ulet nga 2.69 në 2.45, me çka paga e tyre e janarit prej 108.877 denarësh do të ulet në 108.564 denarë.

Ministrat me këto ndryshime do të kenë koeficient të ulur të pagës nga 2.85 në 2.6, që do të thotë se paga e tyre e janarit prej 115.353 denarësh do të ulet në 115.211 denarë.

Pushteti dhe opozita e shohin nga prizma të ndryshme pagën e deputetëve

Sipas propozuesve të ndryshimeve ligjore, ulja e koeficientit do t’u sjellë funksionarëve pagë më të ulët prej 10 deri në 13 mijë denarësh. “Për deputetët dhe funksionarët në pushtetin ekzekutiv i ulim koeficientet me çka drejtpërdrejt e shkurtojmë barrën buxhetore. Për gjyqtarët dhe prokurorët publikë parashikojmë harmonizim të koeficienteve me qëllim që pagat e tyre të jenë në korrelacion me mundësitë reale ekonomike të shtetit. Ndërsa për kryetarët e komunave propozojmë shkallë të re varësisht nga numri i banorëve”, deklaroi deputeti Bojan Stojanoski.

Me këtë qëndrim nuk pajtohet deputeti nga opozita e LSDM-së,

Oliver Spasovski, i cili pretendon se ky është manipulim, sepse nuk mund të zbritesh diçka që nuk e ke marrë. Ai thotë se grupi parlamentar i LSDM-së do t’i mbështesë ndryshimet me të cilat rritet paga e tyre. “Pra, pretendimi se po i ulin pagat për 200 ose 300 euro nuk është aspak i vërtetë. Sepse praktikisht ne do t’i rrisim pagat në këtë nivel që është tani, sepse nuk mund të konsiderohet si ulje diçka që në të ardhmen do ta merrnim. Kështu që ne do ta mbështesim një gjë të tillë. Pse? Sepse konsiderojmë se prioritet duhet të jenë punëtorët, prioritet duhet të jetë paga minimale”, thotë Spasovski për REL.

Ai shton se problemi në manipulim është se shumica qeverisëse në Kuvend nuk votoi për rritjen e pagës minimale, por vetëm për ndalimin e rritjes së pagës së funksionarëve.

LSM: Deputetët nuk i ulën pagat e tyre

Kryetari i Lidhjes së Sindikatave, Slobodan Trendafilov, thotë se në Kuvend kanë propozuar ndryshime ligjore me të cilat baza e pagës së funksionarëve do të shumëzohet me pagën minimale në vend të asaj mesatare, me çka realisht do të ulej paga e tyre për 40 përqind. Por, siç thotë ai, për fat të keq, asnjë deputet nuk e mbështeti iniciativën e tyre. “Është e rëndësishme të dihet se ata nuk po i ulin pagat e tyre për 12.000 deri në 13.000 denarë siç përpichen t’ia shpjegojnë këtë publikut, por vetëm po i mbajnë pagat e tyre të rritura për 79%, përkatësisht shumica qeverisëse tregoi se për ta shpëtuar pozitën dhe pagën e vet, në një ditë me procedurë të shkurtuar

ndryshuan 4 ligje, ndërsa dy vjet u duhen për të ndryshuar një ligj për të rritur pagat e punëtorëve dhe ende nuk e ndryshojnë”, thotë Trendafilov.

Prokurorët kërkon tërheqjen e ndryshimeve ligjore nga seanca plenare

Në listën e funksionarëve që do të marrin pagë më të ulët nga ajo e pritshme janë prokurorët dhe gjyqtarët. E para me reagim të ashpër ishte Shoqata e Prokurorëve, e cila kërkoi nga deputetët ta heqin pikën nga rendi i ditës i seancës plenare. Sipas ndryshimeve të propozuara në ligjin për pagat e prokurorëve, pagat e prokurorëve themelorë në mars do të rriten për 273 denarë, ndërsa prokurorëve nga Prokuroria Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit do t’u rritet paga për 134 denarë.

Sipas Shoqatës, është jokushtetues përpjekja e Qeverisë për ndryshimin e koeficienteve në pagat e tyre, sepse, sipas ligjit për pagat e prokurorëve publikë, paga e tyre mund të ndryshohet vetëm pas një procedure të përcaktuar disiplinore. “Konsiderojmë se kjo është një zgjidhje antikushtetuese dhe e paligjshme me të cilën rrezikohet pavarësia e prokurorëve publikë përmes presionit ekonomik”, thuhet në reagimin e tyre.

Më tej ata thonë se paga e tyre, e cila lëviz nga 90.000 deri në 130.000 denarë, është më e ulët në rajon, ku pagat e prokurorëve janë nga 100.000 deri në 270.000 denarë. Prokurorët akuzojnë se shtesat e parashikuara me ligj për kompleksitetin e punës prej vitesh

nuk u paguhen për shkak të mungesës së mjeteve në Buxhet. Ndaj këtij kërkesë të prokurorëve, deputetët nga pushteti u porositën të punojnë për rritjen e besimit, e jo të mendojnë vetëm për paga. “Dhe në vend që të punojnë për rritjen e atij 2% besim nga qytetarët, ata mendojnë ekskluzivisht vetëm për paga. Por, do ta përsëris, bëhet fjalë për një grup të vogël njerëzish që janë nën kontrollin e LSD-së dhe BDI-së, përndryshe edhe atje ka shumë njerëz të ndershmë që për fat të keq nuk mund të vijnë në shprehje nga këta”, deklaroi deputeti nga VMRO-DPMNE, Brane Petrushevski.

Koeficientet për funksionarët deri tani janë ulur dy herë

Kjo është hera e tretë që ulen koeficientet për pagat e funksionarëve pasi Gjykata Kushtetuese e “zhbllokoi bazën”. Në dhjetor 2024, deputetët në Kuvend nga radhët e VMRO-DPMNE-së, Bojan Stojanoski, Dafina Stojanoska dhe Eli Panova, paraqitën propozim-ndryshime në Ligjin për pagën dhe kompensimet e tjera të personave të zgjedhur dhe të emëruar, me të cilat u ulën koeficientet e pagave. Atëherë nga 3.92 si koeficienti më i lartë për përcaktimin e pagës së presidentit të shtetit, kryetarit të Kuvendit dhe kryeministrit, u ul në 3.47.

Një veprim të tillë e bëri edhe pushteti i mëparshëm i udhëhequr nga LSDM dhe BDI në shkurt 2024, kur me ndryshime në gjashtë ligje ndaluan rritjen e të ardhurave mujore të bartësve të funksioneve publike duke e ulur koeficientin më të lartë nga 4.50 në 3.92.

80 PËR QIND E MINATORËVE TË EKSPOZUAR NDAJ RREZIQEVE SERIOZE NË PUNË

PRISHTINË, 27 SHKURT - Instituti për Hulumtime dhe të Drejtat e Njeriut (IHDNJ) ka lansuar hulumtimin “Punëtorët e Padukshëm të Nëntokës”, duke kërkuar hartimin e një liste zyrtare të sëmundjeve profesionale për minatorët e Kosovës dhe ndryshime ligjore që do t’u mundësonin atyre njohjen e këtyre sëmundjeve dhe pensionim të parakohshëm. Sipas hulumtimit, 80 për qind e minatorëve janë vazhdimisht të ekspozuar ndaj rreziqeve serioze në punë, ndërsa 58 për qind janë diagnostifikuar me sëmundje gjatë vitit të fundit. Drejtoresha ekzekutive e IHDNJ-së, Kaltrina Rexhepi, tha se iniciativa synon përmirësimin e jetës dhe shëndetit të minatorëve përmes ndryshimeve ligjore dhe krijimit të një liste zyrtare të sëmundjeve profesionale, duke theksuar nevojën që atyre t’u njihet e drejta për pensionim para moshës 65-vjeçare. “Nuk dua të flas sot për kontributin e minatorëve, edhe pse jemi në përmbyllje të javës së minatorëve, në 37-vjetorin e përmbylljes së javës së minatorëve dhe kontributin e

tyre gjatë asaj periudhe të lavdishme sepse është një gurthemel i lirisë që ne sot e gëzojmë dhe jetojmë. Por ajo që sot dua të ndalem konkretisht është shëndeti, jeta dhe puna e minatorëve në ditët e sotme dhe kontributi i tyre në ditët e sotme. Kjo është një iniciativë konkrete e iniciuar nga Instituti për Hulumtime dhe të Drejtat e Njeriut për realizimin e një liste të sëmundjeve profesionale dhe gjithashtu për ndryshimet legjislative që duhet të ndërmerren që minatorëve t’u njihet kontributi i punës dhe nevoja për një pensionim të parakohshëm dhe jo ashtu siç ekziston deri më tani deri në moshën 65-vjeçare”. Rexhepi theksoi se pas hulumtimit hapi konkret që synojnë është të arrihet inicimi i ndryshimeve ligjore. Ministri për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, Andin Hoti, vlerësoi se gjetjet e hulumtimit përbëjnë bazë për veprim institucional, duke paralajmëruar forcim të mekanizmave të monitorimit dhe vazhdim të mbështetjes për pensionim të parakohshëm sipas legjislacionit në fuqi si dhe procedimin e ndryshimeve




ligjore që lidhen me këtë fushë. “Gjetjet e këtij hulumtimi që janë bërë për shëndetin dhe sigurinë në punë, kushtet e punës dhe trajtimi i sëmundjeve profesionale të minatorëve përbëjnë një bazë të mjaftueshme për refleksion institucional dhe veprim të koordinuar. Ne do t’i forcojmë mekanizmat e monitorimit dhe

inspektimit si Ministri, me qëllim të garantimit të standardeve sa më të larta të sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Njëkohësisht përmes skemave të financuara nga shteti, ne do të vazhdojmë të sigurojmë realizimin e të drejtës për pension të parakohshëm për punëtorët e ndërmarrjes Trepça, të cilët përmbushin

kriteret sipas legjislacionit në fuqi”, tha ai. Ambasadori i Suedisë në Kosovë, Jonas Westerlund, theksoi se njohja e sëmundjeve profesionale është çështje e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe e forcimit të besimit në institucione, duke bërë thirrje për kalim nga diskutimet në rezultate konkrete.

OSMANI I THOTË PRATTIPATIT SE PRANIA USHTARAKE AMERIKANE NË KOSOVË MBETET E RËNDËSISHME

PRISHTINË, 27 SHKURT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim të ngarkuarën me punë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Anu Prattipati, me të cilën ka diskutuar për vizitën e saj të fundit në ShBA dhe takimet me zyrtarë të lartë të administratës amerikane, zhvillimet e fundit në vend, si dhe çështje të ndryshme me interes të përbashkët. Presidentja Osmani shprehu edhe njëherë mirënjohje për ftesën e presidentit amerikan Donald Trump, që Kosova të jetë shtet bashkëthemelues i Bordit të Paqes, si dhe për garancitë e dhëna për paqen dhe stabilitetin në rajon, duke rikonfirmuar përkushtimin e Kosovës për angazhim dhe kontribut të vazhdueshëm. Ajo veçoi çështjet e diskutuara në takimin me sekretarin e Shtetit, Marco Rubio, duke theksuar



diskutimet e fokusuara në avancimin e partneritetit strategjik Kosovë - ShBA, me theks në sigurinë rajonale, diplomacinë, ekonominë dhe

mbrojtjen. Presidentja ritheksoi rëndësinë e pranisë ushtarake amerikane dhe të aleatëve në kuadër të NATO-s si faktor kyç për stabilitetin si dhe

theksoi se anëtarësimi i Kosovës në NATO mbetet objektiv strategjik për paqe afatgjatë. Me këtë rast, presidentja Osmani nënvizoi sërish rëndësinë e

vijimit të dialogut strategjik bilateral, duke theksuar se partneriteti me ShBA-në është interes jetik dhe ekzistencial për Republikën e Kosovës. Gjatë takimit u diskutua edhe për zhvillimet e fundit politike në vend, me theks në rëndësinë e përmbylljes së proceseve kushtetuese dhe konsolidimit të plotë institucional, në funksion të stabilitetit demokratik, zhvillimit të vendit dhe adresimit të nevojave të qytetarëve. Duke folur për zhvillimet e fundit në vend, presidentja Osmani vuri në pah edhe përmirësimet e dukshme në fushën e sigurisë dhe sundimit të ligjit në veri të vendit, të reflektuara në raportet e fundit të Policisë së Kosovës për rendin dhe ligjin gjatë vitit 2025. Sipas këtyre të dhënave, konfirmohet një situatë dukshëm më e qetë dhe më e sigurt për të gjithë qytetarët në atë pjesë të vendit.

Kurti e emëron Ragmi Mustafin këshilltar politik për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc

PRISHTINË, 27 SHKURT - Ragmi Mustafi ka njoftuar se me vendim të kryeministrit të Republikës së Kosovës vazhdon detyrën e këshilltarit politik për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc. “Falënderoj kryeministrin Albin Kurti, për besimin e

rikonfirmuar dhe për përkushtimin që institucionet e Republikës së Kosovës po tregojnë në trajtimin e çështjeve që prekin shqiptarët në Luginën e Preshevës. Është nder të vazhdoj këtë përgjegjësi sepse kufijtë administrativë nuk mund të

kufizojnë përgjegjësinë kombëtare. Sepse të drejtat e shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc nuk janë çështje e jashtme e Kosovës. Janë provë e karakterit të saj politik. Prandaj puna vazhdon”, ka shkruar ai në “Facebook”.



DERISA PRITEN FATURAT E REJA TË RRYMËS, KOSOVA PAGUAN EDHE PËR BLOKADËN SERBE

PRISHTINË, 27 SHKURT - Kur Kosova paguan deri në 800 euro për të transportuar një megavat orë (MWh) energji, qytetarët nuk paguajnë vetëm për rrymën që u shkon në prizë. Ata paguajnë edhe për pasojat e një bllokade politike, për tensionet me fqinjët dhe për dobësitë e një sistemi energjetik që nuk arrin t'i mbulojë nevojat bazë të vendit.

Që nga viti 2020, kur Serbia blloko i linjën e transmisionit me Kosovën, u kufizuan rrugët më të shkurtra dhe më të lira për importimin e energjisë, duke e detyruar vendin të përdorë alternativa më të kushtueshme. Si rezultat, koston shtesë u reflektuan drejtpërdrejt edhe në faturat e energjisë për qytetarët dhe bizneset.

Me shpalljen e tarifave të reja vjetore, që pritet të bëhet deri në fund të muajit të ardhshëm, pasiguria vazhdon të mbetet e lartë, pasi nuk përjashtohet mundësia e një tjetër rritjeje të çmimit të energjisë elektrike.

Shpresë për ndryshim ka, pasi Serbia është obliguar që deri më 1 korrik ta lejojë tregtimin e energjisë me Kosovën, por mbetet e paqartë nëse ky vendim do të zbatohet në praktikë.

Pse Kosova importon energji?

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) nuk mjafton për ta përballuar kërkesën e konsumatorëve për energji elektrike sidomos gjatë dimrit. Termocentralet me qymyr janë të vjetra dhe shpesh ndalojnë së punuari për shkak të prishjeve dhe mirëmbajtjes, ndërsa prodhimi nga burimet e ripërsëritshme mbetet i vogël. Vetëm nga janari deri në nëntor të vitit të kaluar Kosova shpenzoi rreth 250 milionë euro për blerje të energjisë nga jashtë.

Çmimet e transportit arritën në nivele astronomike - deri në 800 euro për MWh në ditë të caktuara gjatë vitit të kaluar, sipas Ministrisë së Ekonomisë. Autoritetet e konsiderojnë bllokimin e linjës së transmisionit nga Serbia si faktorin kryesor që rrit koston e importit dhe të transportit. Për një vend me rreth 1.5 milion



Sa kushton aktualisht energjia elektrike?

Sipas tarifave aktuale, konsumatorët familjarë që shpenzojnë deri në 800 kilovat-orë (kWh) në muaj, paguajnë 9.05 centë për kilovat-orë. Konsumatorët që e tejkalojnë

këtë prag, paguajnë 15.43 centë për kilovat-orë për energjinë e shpenzuar mbi këtë nivel. Ndërkohë, gjatë tarifave të ulëta - që zbatohen nga ora 23:00 deri në 08:00 - çmimet janë më të

favorshme: konsumatorët që shpenzojnë deri në 800 kWh paguajnë 3.88 centë për kilovat-orë, ndërsa ata që e tejkalojnë këtë prag, paguajnë 7.28 centë për kilovat orë.

banorë dhe një ekonomi në zhvillim, këto kosto përbëjnë një barrë të konsiderueshme financiare, pasi rritja e shpenzimeve për energji ndikon jo vetëm në buxhetin e shtetit, por edhe në konkurrueshmërinë e bizneseve dhe në rritjen e çmimeve për konsumatorët. “Si pasojë e bllokadës nga ana e Serbisë, deri në 600 MW kapacitet transmisioni në kufirin Kosovë-Serbi nuk shfrytëzohet për shkëmbime komerciale - çfarë ushtron presion të vazhdueshëm mbi linjat e tjera ndërkufitare”, thonë nga Ministria e Ekonomisë e Kosovës për Radion Evropa e Lirë.

Origjina e bllokadës

Problemi filloi në dhjetor të vitit 2020, kur Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT) filloi të operojë në mënyrë të pavarur. Kosova doli nga blloku rregullues me Serbinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut dhe u bashkua me Shqipërinë, duke aktivizuar linjën interkonektive

400 kV Kosovë-Shqipëri, e njohur si “Autostrada energjetike Kosovë-Shqipëri”. Që nga ajo kohë, Serbia blloko i linjat e transmisionit të energjisë në Kosovë, dhe vendi u detyrua të tregtonte përmes kufijve me Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi.

Sipas Ministrisë së Ekonomisë, ky devijim “politik” i ka kushtuar Kosovës miliona euro në vit - konkretisht rreth 150 milionë vetëm në vitin 2024.

Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe kundërshton pjesëmarrjen e saj të plotë në mekanizmat ndërkombëtarë, përfshirë sektorin energjetik. Në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve, dy vendet arritën Marrëveshje për Energjinë në vitet 2013 dhe 2015, ndërsa në qershor 2022 miratuan edhe Udhërrëfyesin për zbatimin e tyre. Por, si shumë të tjera, as ato nuk u zbatuan kurrë plotësisht.

KOSTT-i konfirmon se Elektro-ekonomia e Serbisë (EMS) nuk ka nënshkruar ndonjë marrëveshje për tregtim të kapaciteteve me Kosovën. “Që nga ajo periudhë [2020] e deri

më sot nuk ka pasur dhe vazhdon të mos ketë tregti komerciale të energjisë elektrike në kufirin me Serbinë”, thuhet në përgjigjen e KOSTT-it për Radion Evropa e Lirë. REL-i kërkoi qëndrim nga operatori serb, EMS, lidhur me këtë çështje, por nuk mori përgjigje.

Pasojat në tregun energjetik

Mosalokimi i kapaciteteve në kufirin Kosovë-Serbi ka kufizuar konkurrencën, ka zvogëluar rrugët alternative për import dhe ka rritur kërkesën dhe çmimet në kufijtë e tjerë. Ministria e Ekonomisë thotë se ky është një faktor që ka ndikuar pjesërisht në rritjen e tarifave për konsumatorët, të cilat vitin e kaluar u shtrenjtuan për rreth 16%.

Muajin e kaluar, tre operatorët energjetikë në Kosovë kërkuar rritjen e tarifave të energjisë elektrike edhe për këtë vit. Eksperti i çështjeve energjetike, Nebih Zariqi, shpjegon për Radion Evropa e Lirë: “Është si me rrugët tokësore - kur rruga më e shkurtër është e bllokuar,

duhet përdorur rrugë më të gjata - gjë që rrit automatikisht koston e transportit. Tregtarët mund të manipulojnë edhe me çmimet për MWh”.

Megjithatë, as KOSTT-i dhe as Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) nuk kanë publikuar shifra për vlerën totale të paguar për këto linja transmetimi gjatë pesë vjetëve të fundit.

Përpjekjet për zgjidhje

KOSTT e ka ngritur këtë problem në nivel rajonal dhe evropian, duke hapur rast në Komunitetin e Energjisë.

Dhjetorin e kaluar Kosova mori kryesimin e kësaj organizate ndërkombëtare, qëllim i së cilës është ta mbështesë rrugën e vendeve anëtare të saj drejt anëtarësimit në BE, përmes zbatimit të ligjeve energjetike të BE-së.

Këshilli i Ministror të Komunitetit të Energjisë vendosi atëkohë që Serbia duhet të lejojë tregtimin e energjisë me Kosovën më së largu deri më 1 korrik 2026. “Ky bllokim, i cili ka vazhduar për më shumë se pesë vjet, ka shkaktuar pasoja të drejtpërdrejta negative në funksionimin e sistemit energjetik të Kosovës, duke rritur ngarkesën e rrjetit dhe koston e transmisionit përmes linjave alternative me Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Republikën e Shqipërisë”, tha ministrja e Energjisë, Artane Rizvanolli, dhjetorin e kaluar. Ministria e saj zotohet se do të monitorojë nga afër zbatimin e këtij vendimi.

Përkundër përpjekjeve, Radio Evropa e Lirë nuk mori përgjigje nga operatori serb, EMS, ose nga Këshilli i Ministror të Komunitetit të Energjisë lidhur me masat që do të ndërmerren nëse linjat nuk hapen në afatin e caktuar.

Nëse bllokada vazhdon, Kosova do të mbetet e detyruar të importojë energji përmes rrugëve më të gjata dhe më të shtrenjta, duke rritur më tej koston për qytetarët dhe ekonominë.

Në afat të gjatë, kjo situatë mund të ndikojë edhe në sigurinë energjetike të vendit dhe në aftësinë e tij për të tërhequr investime.


Rama me kryetarin e OEK-ut: Zhvillimi ekonomik kërkon bashkëpunim dhe zgjidhje konkrete

PRISHTINË, 27 SHKURT - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka takuar kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, me të cilin kanë diskutuar për bashkëpunimin në arsimin

dual dhe iniciativat për avancimin e standardeve profesionale. “Si lider në zbatimin e arsimit dual, Qendra për Arsim Dual në kuadër të OEK-ut do të shërbejë edhe për edukim praktik të nxënësve dhe

studentëve, duke forcuar kapacitetet dhe shërbimet për bizneset e kryeqytetit”, ka thënë Rama, duke shtuar se zhvillimi ekonomik kërkon bashkëpunim dhe zgjidhje konkrete.





Bologna - Roma, dueli italian në Ligën e Evropës

NYON, 27 SHKURT - Është hedhur shorti i fazës së 1/8 të finales së UEFA Europa League, ku janë përcaktuar tetë përballje që premtojnë spektakël dhe emocione të forta. Një nga duelet më interesante të kësaj faze do të

jetë përballja mes Bologna dhe AS Roma, një sfidë e gjitha italiane që pritet të dhurojë rivalitet të madh dhe atmosferë të zjarrtë. Faza e 1/8 të finales pritet të sjellë ndeshje të forta dhe beteja të ashpra për një vend

në çerekfinale, duke rritur edhe më shumë interesimin e tifozëve për garën evropiane. Duele të tjera janë: Lille - Aston Villa, Stuttgart - Porto, Nottingham Forest - Midtjylland, Ferencvarosh - Braga,

Panathinaikos - Real Betis, Genk - Freiburg dhe Celta - Lyon. Ndeshjet e para do të luhen më 12 mars, ndërsa ato kthyese pas një jave. Finalja e këtij edicioni do të luhet në stadiumin e Beshiktashit në Stamboll.

PËRFUNDON RRUGËTIMI HISTORIK I DRITËS NË GARAT EVROPIANE

CELJE, 27 SHKURT - Skuadra kampione në fuqi, Drita, nuk ka arritur të kualifikohet në 1/8 e finales në UEFA Conference League, pasi edhe në ndeshjen e kthimit të "play-off"-it ka pësuar humbje nga Celje me rezultat si në "Fadil Vokrri" (3:2). Celje ka kaluar në epërsi që në minutën e 18 me golin e Svit Seshlar dhe më pas mesfushori Darko Hrka ka dyfishuar rezultatin në minutën e 23-të. Blerim Krasniqi ka ngushtuar diferencën për Dritën në minutën e 26 me një gol me kokë pas harkimit të Besnik Krasniqit. Pavarësisht prej tentativave të tjera për të barazuar, ishin vendasit që shënuan golin e tretë, duke e

mbyllur pjesën e parë 3:1. Në pjesën e dytë Albert Dabiqaj ka realizuar për 3:2, por Celje ka arritur ta mbajë avantazhin dhe ta eliminojë Dritën nga garat evropiane, e cila, megjithatë, në këtë edicion ka regjistruar suksesin më të madh nga klubet e Kosovës deri më tash me arritjen në "play-off". Fillimisht Drita kishte kaluar në raundin e parë të Ligës së Kampionëve, mirëpo ishte eliminuar në raundin e dytë, duke vendosur një rekord qysh në start si skuadra e parë që e kalon rrethin e parë kualifikues të ligës më prestigjioze në botë. Pas kësaj, Drita kishte rënë në Ligën e Evropës ku ishte mposhtur nga gjiganti rumun



FCSB në raundin e tretë kualifikues, kësajherë i ishte nevojitur me patjetër një fitore në "play-off"-in e Ligës së Konferencës për t'i arritur grupet. Këtë e bënë shumë lehtë, duke mposhtur Differdange në të dy

përballjet dhe për t'u bërë klubi i dytë pas Ballkanit që shkon në fazën e grupeve. Edhe në grupe Drita ka dëshmuar mentalitetin e fortë ku në gjashtë ndeshje ka arritur t'i arkëtojë tetë pikë, që s'kishte ndodhur kurrë më

parë, njëkohësisht kishte siguruar "biletën" për në play-off. Në "play-off", Drita ka pasur punë me Celjen e Milot Avdyllit, ku skuadra sllovene ka arritur ta mposhtë dy herë për ta eliminuar përfundimisht nga garat evropiane. Përpos arritjeve të jashtëzakonshme në aspektin sportiv, Drita ka fituar edhe shumë para. Është raportuar për mbi 6 milionë euro. Kësajherë, kampioni i Kosovës tani është fokusuar që ta mbrojë sërish titullin me shpresën që të përsërisë atë që arriti në kualifikueset e fundit. Kujtojmë, Drita është lidere në tabelë, dy pikë para Ballkanit e Prishtinës.

REAL MADRID - MAN CITY, PËRBALLJA KRYESORE E 1/8 SË FINALES NË LIGËN E KAMPIONËVE

NYON, 27 SHKURT - Në Nyon të Zvicrës është tërhequr shorti për 1/8 e finales së Ligës së Kampionëve, duke prodhuar disa përballje spektakolare që pritet t'i mbajnë të mbërthyer tifozët e futbollit evropian. Vëmendja kryesore, pa dyshim, do të jetë te supersfida në mes të Real Madridit dhe Manchester City, një duel që tashmë është shndërruar në një klasik modern të kompeticionit. Dy gjigantët evropianë do të përplasen sërish për një vend në çerekfinale, në një përballje që premteton spektakël dhe emocione të forta. Një tjetër ndeshje e



fortë pritet të jetë ajo ndërmjet Chelsea dhe Paris Saint - Germain (PSG), ku përvoja dhe ambicia për trofe

do të vihen përballë njëra-tjetrës. Ndërkohë, shorti ka rezervuar edhe përballje të tjera interesante. Barcelona

do ta sfidojë Newcastle Unitedin, në një duel që rikthen anglezët në skenën e madhe evropiane. Liverpools do të përballlet me Galatasarayn, ndërsa Bodø/Glimt do t'i masë forcat me Sporting CP. Po ashtu, në garë janë edhe përballje të forta si Tottenham Hotspuri kundër Atlético Madridit, Bayern Munich ndaj Atalantas si dhe Arsenali përballë Bayer Leverkusenit. Tetë skuadrat që siguruan kualifikimin direkt në këtë fazë do të kenë përballë fituesit e fazës së "play-off"-it, duke e bërë garën edhe më të fortë dhe të paparashikueshme.

Ndeshjet e para të 1/8 të finales së Ligës së Kampionëve pritet të zhvillohen në fillim të pranverës, aty ku do të nisë beteja e vërtetë për një vend në mesin e tetë më të mirave të Evropës.

ÇIFTET E RAUNDIT TË 16-të NË LIGËN E KAMPIONËVE

Real Madrid - Man City
Bodo/Glimt - Sporting Lisbon
Chelsea - PSG
Barcelona - Newcaslte
Liverpool - Galatasaray
Tottenham - Atletico Madrid
Bayern Munich - Atalanta
Arsenal - Bayer Leverkusen

Juventusit ia rinovon kontratën Luciano Spallettit

TORINO, 27 SHKURT - Trajneri i Juventusit, Luciano Spalletti, ka arritur një marrëveshje në parim me klubin për zgjatjen e kontratës, sipas gazetarit Nicolo Schira. Tekniku italian

66-vjeçar mund të nënshkruajë një marrëveshje të re me klubin italian që do ta mbajë në detyrë deri në vitin 2028. Spalletti është i gatshëm ta vazhdojë kontratën në javët

në vijim pavarësisht prej interesimit nga dy klube të paemërtuara jashtë Italisë. Ai kishte marrë drejtimin e Juventusit në tetor të vitit 2025 dhe aktualisht ka kontratë deri

më 30 qershor 2026. "Bianconerët" renditen aktualisht në vendin e pestë në tabelën e Serisë A dhe këtë javë janë eliminuar nga Liga e Kampionëve.





Institucion i Arsimit dhe Aftësimi Profesional (IAAP) "Ymer Prizreni" Prizren
e-mail: mgavazaj@hotmail.com
Nr.tel.038/20035377
facebook:"Ymer Prizreni"



Nr.protokoli-86/2026

Në bazë të Rregullorës nr.01/2017,datë 02.02.2017, Ligjit NR.04/L-143, nenit 12 për Arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës , Drejtoresha e IAAP "Ymer Prizreni" në Prizren, vendos për pranimin e nxënësve në arsimin për të rritur dhe me këtë rast publikon këtë:

KONKURS

EKONOMI

- 1.Kontabilitet dhe tatime..... 1 paralel 24 nxënës
2.Tregti me pakicë e shumicë..... 1 paralel 24 nxënës

HOTELERI

- 1.Asistent restoranti.....1 paralel 24 nxënës

TEKNOLOGJI USHQIMORE

- 1.Teknologji ushqimore.....1 paralele 24 nxënës

ADMINISTRATË

- 1.Administrim dhe shërbime të zyrës..... 1 paralel 24 nxënës

Kushtet:

Dokumentacioni (dëftesa e shkollimit paraprak,certifikata e lindjes, dhe letërnjoftimi i fotokopjuar).

Pagesa bëhet sipas rregullores së MASHT-it Nr.11/2011 Dt.:30.12.2011 dhe Rregullores për tarifa,taksa,ngarkesa dhe gjoba nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale nr.01/11.

1. Për regjistrimin e vitit për një klasë: 100 €
2. Praktika profesionale 50 €
3. Lënda me shkrim dhe me gojë 10 €
4. Lënda me gojë 8€
5. Për diplomë(përfundimi i shkollimit): 50€
6. Provime diferenciale 10€

Vijueshmëria në mësim

Kandidatët e pranuar janë të obliguar që t'i ndjekin 18 javë mësimi nëse klasa e profilit përkatës numëron mbi 15 nxënës, dhe në fund t'i nënshtrohen testit vlerësues në të gjitha lëndët e parapara për arsimin për të rritur.

Për klasë ku numri i nxënësve është nën 15 nxënës, organizohet mësimi konsultativ.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në gazetë.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Royal Company" Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 810069692 dhe ka caktuar likuidatorin Aziz Tërmkolli për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Royal Company" D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810069692 ujedno imenovao Likvidatora Aziz Tërmkolli o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Royal Company" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810069692 the company has appointet a liquidator Aziz Tërmkolli wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Institucion i Arsimit dhe Aftësimi Profesional (IAAP) "Ymer Prizreni" Prizren
e-mail: mgavazaj@hotmail.com
Nr.tel.038/20035377
facebook:"Ymer Prizreni"



Nr prot.200
Datë 27/02/2026

FTESË PËR OFERTË

Për ekskursionin e maturanëve të IAAP "Ymer Prizreni"në Prizren në Republikën e Shqipërisë .

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Kompanitë turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarfë të mbyllur, për ekskursionin e maturanëve të IAAP "Ymer Prizreni"në Prizren për në Republikën e Shqipërisë ,më datën 04/05/2026 deri më 08/05/2026

Pjesëmarrësit e interesuar në tender për dokumentacionin dhe kushtet e kërkuara nga ana e shkollës i kanë të paraqitura në aplikacion.

Ofertuesit e interesuar aplikacionet dhe itinerarin e udhëtimeve mund t'i marrin në administratën e shkollës dhe të kompletuar me dokumentacionin të dorëzohen në DKA në Prizren.

Afati i paraqitjes në tender është 7 ditë pune, nga dita e publikimit në gazetë.

Të interesuarit aplikacionet mund t'i tërheqin në lokalet e shkollës prej orës 8:00 deri në orën 15:00 dhe atë gjatë ditëve të punës.

Vërejtje: Tërheqja e aplikacioneve nuk mund të bëhet ditën e shtunë dhe të diel, për shkak se këto dy ditë nuk punon administrata e shkollës.

Shkolla mban të drejtën për anulimin e ofertës.

OBAVEŠTAVAMO

Našeg suvlasnika sa suvlasničkom deom **1/14 Reimka (Bajram) Sadiki** , kao zainteresovanog kupca da mi kao suvlasnici na parceli : **P-71813063-00289-3 ZK Petrovo Selo Opština Prizren** sa suvlasničkim delovima : **Sadiki (Bajram) Asim 1/8 , Sadiki (Bajram) Safeta 1/14 , Redza (Bajram) Fatime 1/14 , Sadiki (Bajram) Veljija 1/8 , Sadiki (Bajram) Atima 1/8 , Sadiki (Bajram) Jasmina 1/14 , Sadiki (Bajram) Asima 1/14 , Sadiki (Bajram) Xhelil , 1/14 , Sadiki (Bajram) Ramadan 1/8 , Krasniqi (Bajram) Mida 1/14 prodajemo u celosti naše suvlasničke delove .**

Shodno zakonskim propisima o prodaji nepokretnosti neophodno je da se prodaja ponudi najpre suvlasniku koji ima pravo na preče kupovine pa ako moj suvlasnik ne želi da kupi onda se ta prodaja moze izvršiti drugim licima odnosno kupcem .

Ovim putem nudimo suvlasniku ukoliko je zainteresovan za kupovini da se javi u roku od **30 dana** platiti sveukupnu cenu **kupoprodajnu cenu od 225.000 €** I to načinom uplate u gotovini / odjednom .

Kontakt Telefon : **045473300**

Prizren : 27-02-2026 .

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbropa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

OBAVEŠTAVAMO

Našeg suvlasnika sa suvlasničkom deom 1/14 Reimka (Bajram) Sadiki , kao zainteresovanog kupca da mi kao suvlasnici na parceli : P-71813063-00289-3 ZK Petrovo Selo Opstina Prizren sa suvlasničkim delovima : Sadiki (Bajram) Asim 1/8 , Sadiki (Bajram) Safeta 1/14 , Redza (Bajram) Fatime 1/14 , Sadiki (Bajram) Veljija 1/8 , Sadiki (Bajram) Atima 1/8 , Sadiki (Bajram) Jasmina 1/14 , Sadiki (Bajram) Asima 1/14 , Sadiki (Bajram) Xhelil , 1/14 , Sadiki (Bajram) Ramadan 1/8 , Krasniqi (Bajram) Mida 1/14 prodajemo u celosti naše suvlasničke delove .

Shodno zakonskim propisima o prodaji nepokretnosti neophodno je da se prodaja ponudi najpre suvlasniku koji ima pravo na preče kupovine pa ako moj suvlasnik ne želi da kupi onda se ta prodaja moze izvršiti drugim licima odnosno kupcem .

Ovim putem nudimo suvlasniku ukoliko je zainteresovan za kupovini da se javi u roku od 30 dana platiti sveukupnu cenu **kupoprodajnu cenu od 225.000 €** I to načinom uplate u gotovini / odjednom .

Kontakt Telefon : 045473300

Prizren : 27-02-2026 .

Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejepuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Korab Polloshka shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Ahmet Ademaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I-VIII të SH.F.M.U. “Lekë Dukagjini” Prizren.
- Asllan Babaj shpall te pavlefshme dëftesat e vitit I,II,III dhe diplomën e shkollës së mesme të lartë të gjimnazi “Frang Bardhi”.
- Doni ES Sh.p.k. shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër unik identifikues 811273507.
- Florentina Trepça shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të lartë “Dr, Xheladin Deda”.
- Sami Mustafa shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fehmi Rama” ish shkolla fillore “Emin Duraku” Likoc Skenderaj.
- Hysen Ferizi shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Azem Bejta” Prekaz i Eperm Skenderaj.
- Rrustem Tahiri shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Trepça” Stanterg.
- Drita Zabeli shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Malush Ahmeti” ish shkolla “Muharrem Bekteshi” Rezalle Skenderaj.

- Milaim Sh. Hajdari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike mekanik i radiotelevizionit të shkollës “Gjin Gazulli” Prishtinë.
- Kujtim Hakaj shpall të pavlefshme diplomën e sh, profesionale “Dituria” Prizren.
- Tahir Neziri shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Kuvendi i Juniku” Junik.
- Zejnie Morina shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Xhelal Hajda Toni” Ratkoc Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1904

Columbus, Georgia, USA
0.5L